



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Universitetit Katolik
“Zoja e Këshillit të Mirë”
Qershor 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

- | | | |
|---|----------------|---------|
| 1 | Kevin Kendall | Kryetar |
| 2 | Janthia Taylor | Anëtare |
| 3 | Gjergj Thomai | Anëtar |

Data: nga 29 deri në 30 qershor 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raport i përmbledhur.....	6
Përmbledhje e gjetjeve	8
Raporti i detajuar	10
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	10
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	23
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	28
Lista e dokumenteve	31

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (UniZKM) është një institucion privat jofitimprurës i arsimit të lartë me seli qendrore në Tiranë, dhe një filial në Elbasan. Universiteti u themelua në gusht të vitit 2004, pas një marrëveshjeje të lidhur në vitin 1993 ndërmjet Kishës Katolike dhe Qeverisë Shqiptare, dhe një vizite të mëparshme nga Nënë Tereza. Misioni i Universitetit Katolik ‘Zoja e Këshillit të Mirë’, sipas frymës edhe së Themeluesit të tij, është të kontribuojë në zhvillimin e arsimit universitar, të kërkimit shkencor dhe të formimit të vazhdueshëm, me qëllim që të përgatisë të diplomuar, ekspertë dhe specialistë të nivelit evropian, studentë të formuar sipas vlerave më të mira morale, të aftë të ndihmojnë në zhvillimin material dhe shpirtëror të shoqërisë. Universiteti Katolik ‘Zoja e Këshillit të Mirë’ i përmbush këto objektiva nëpërmjet arsimit të nivelit më të lartë universitar, një qasjeje edukuese të bazuar te standardet më të përditësuara dhe më të larta të mësimdhënies dhe të frymëzuar nga parimet e doktrinës shoqërore të Kishës Katolike, në veçanti te respektimi i të drejtave themelore të njeriut, të barazisë ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë, etnive të ndryshme, besimeve fetare dhe kombësive, sipas konceptit që shkenca është në shërbim të njeriut dhe të bashkëjetesës së paqte shoqërore.

Universiteti dhe themelimi i fakulteteve të tij është zhvilluar sipas periudhave të mëposhtme:

2004-2005 Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Sociale.

2005-2006 Fakulteti i Farmacisë.

2015-2016 Fakulteti i Shkencave të Aplikuara.

Universiteti ofron tre programe të ciklit të parë, shtatë të ciklit të dytë dhe të integruara të ciklit të dytë, dhe dy programe të ciklit të tretë, në një sërë degësh që lidhen me fakultetet e sipërpërmendura. Këtu përshihet infermieristika, fizioterapia, mjekësia, odontoatria, farmacia, ekonomia e ndërmarrjes, shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe sipërmarrja në sektorin e zhvillimit. Të gjithë studentët ndjekin studime me kohë të plotë, ku 620 prej tyre studiojnë në programet Bachelor, 50 në programet Master, 1288 në programet e integruara Master dhe 20 në programet e doktoraturës. 439 studentë kanë nënshtetësi italiane, disa vijnë nga Kosova dhe vendet fqinje, dhe të tjerë nga Amerika e Veriut dhe e Jugut.

Një veçori e universitetit është bashkëpunimi i ngushtë me universitetet italiane, si dhe fakti që të gjitha programet e studimit ofrohen në gjuhën italiane. Objektivat janë garantimi i një standardi dhe cilësie të krahasueshme me këto universitete, dhe pajisja me diplomë të njohur në vendet evropiane, veçanërisht duke i pajisur studentët me diploma të përbashkëta me partnerët e bashkëpunimit. Staf i akademik përbëhet nga 295 pedagogë me kohë të plotë, prej të cilëve 257 kanë nënshtetësi të huaj, kryesisht italiane. Përveç kësaj, universiteti ka 221 pedagogë me kohë të pjesshme, prej të cilëve 120 kanë nënshtetësi të huaj. I gjithë personeli mbështetës dhe ai administrativ, prej 69 personash, ka nënshtetësi shqiptare.

Nisma të tjera shtesë janë bërë pjesë e zhvillimit të universitetit dhe themelimit të tij si një faktor i rëndësishëm i rajonit. Këtu përfshihet Qendra për Formimin e Deputetëve të Evropës Juglindore, Observatori i Sistemeve Shëndetësore të Ballkanit dhe Qendra Evropiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim.

Një arritje e rëndësishme e kohëve të fundit është akreditimi i universitetit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mars të vitit 2016.

Raport i përmbledhur

Një raport vetëvlerësimi u përgatit nga një grup i vetëvlerësimit në universitet, i cili kishte përfaqësues nga programet e studimit, Njësia e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Kurrikulës, Zyra e Statistikës, Zyra e Financës dhe përfaqësues të studentëve. Grupi organizoi mbledhje me anëtarë të stafit akademik, personelit administrativ dhe mbështetës në universitet, për të mbledhur informacionin e nevojshëm. Këtu përfshiheshin edhe shumë referenca që iu bashkëngjitën raportit në formën e shtojcave.

Projektraportet iu dërguan një audience të gjerë brenda universitetit, para se ato të finalizoheshin dhe të miratoheshin nga Rektori dhe Grupi i Vetëvlerësimit. Institucioni bashkëpunoi tërësisht gjatë procesit të vlerësimit, dokumentacioni u vu në dispozicion në anglisht, dhe sipas kërkesës u ofruan edhe dokumente shtesë.

Vizita u krye gjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve, të caktuar nga APAAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Gjithsej, u shqyrtuan 178 dokumente, të cilat mundësuan njohjen e Grupit të Vetëvlerësimit me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akadematike, Planet e Zhvillimit, raportet vjetore, marrëveshjet e bashkëpunimit, planet e studimit, manualët e studentëve, procedurat e pranimit dhe orientimit, shembuj të informacionit për programet dhe dokumente nga mbledhjet vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë takimesh, që shërbyen për qartësimin e përgjegjësisë, procedurave dhe pikëpamjeve të personelit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, Grupin e Vetëvlerësimit, Drejtorin e Përgjithshëm, dekanët e fakulteteve, përgjegjësit e departamenteve, studentët, stafin akademik, personelin administrativ dhe atë mbështetës, si dhe disa punëdhënës, partnerë dhe alumni.

Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit në korpus, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, laboratorin dentar, laboratorin e anatomisë, laboratorin e histologjisë, laboratorin e fizioterapisë, laboratorin e kimisë, sallën e operacioneve, pishinën e hidroterapisë, auditorët, strukturat e TI-së dhe mensën e studentëve. Pasi shqyrtoi të gjitha provat e vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e mëposhtme.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Në arritjen e këtij përfundimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk bëri pohime. Institucioni dhe strukturat e tij, që funksionojnë në përputhje me Statutin dhe Rregulloret, dhe komisionet e tij zyrtare, garantojnë menaxhim efikas. Universiteti nxit debatin konstruktiv dhe respekton kufijtë e autonomisë së tij. Ai ka një plan zhvillimi afatmesëm dhe afatgjatë, të mbështetur në studimin e tregut, dhe ka partneritete mjaft të dobishme me disa universitete italiane. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si karakteristikë të praktikës së mirë lidhjet që UniZKM-ja ka me universitetet italiane, të cilat lehtësojnë zhvillimin e aftësive teknike që nevojiten në Shqipëri e më gjerë, në Ballkan.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Burimet. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë dhe bëri një pohim të

një veprimi të ndërmarrë. Ata nuk identifikuan asnjë dobësi dhe nuk dhanë asnjë rekomandim. Burimet e shumta fizike për mësimdhënien dhe kërkimin, të cilat ofrojnë mundësinë e të nxënit gjithëpërfshirës praktik dhe empirik, të mbështetur nga një gamë shërbimesh për studentët, janë një karakteristikë e praktikës së mirë. Këtu përfshihen: laborator kompjuterik; klinika dhe laborator dentar; laboratorët e anatomisë, histologjisë, fizioterapisë dhe kimisë; salla e operacioneve; klinika rehabilituese dhe pishina e hidroterapisë. Përveç këtyre, universiteti ofron dhe struktura të tjera, si: salla e konferencave, auditorë, biblioteka qendrore, mensa dhe infrastrukturë plotësisht të aksesueshme për studentët me aftësi të kufizuara fizike. Universiteti ofron akomodim për 35 pedagogë të stafit akademik që vijnë nga Italia. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndërtimin e një spitali brenda korpusit, i cili parashikohet të vihet në funksionim në vitin 2018, si një burim i shkëlqyer për mësimdhënie dhe një aset i vlefshëm për persona nga i gjithë rajoni.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Kurrikulën. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk bëri asnjë pohim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si karakteristikë të praktikës së mirë synimin strategjik të universitetit, për t'iu përgjigjur nevojave të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit, nëpërmjet identifikimit të mangësive në ofertën akademike dhe zgjidhjes së këtij problemi, duke hapur programe të reja. Një karakteristikë tjetër e praktikës së mirë është politika që universiteti ndjek, e cila iu mundëson studentëve shqiptarë njohjen e studimeve të tyre në Evropë, nëpërmjet pajisjes me diploma të përbashkëta me universitetet italiane.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë apo dobësi, dhe nuk dha asnjë rekomandim. Programet e studimit janë të përshtatshme, zhvillohen me përpikmëri, dhe i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme për rritjen e cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi një veprim që po ndërmerrej aktualisht nga universiteti. Kjo lidhet me qasjen mbarinstitucionale të universitetit për vlerësimin e kërkimit shkencor, gjë që përmirëson modelin ekzistues të planifikimit, rrit angazhimin për mbështetjen e atyre kërkimeve me rëndësi për vendin dhe Ballkanin, dhe përforcon qasjen e tij ndaj ndërkombëtarizimit të kërkimit.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, e cila ka të bëjë me faktin që ai është një institucion që e ushtron veprimtarinë e tij në gjuhën italiane dhe është i hapur për studentë të huaj, veçanërisht për ata që vijnë nga Italia. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, nuk bëri asnjë pohim, dhe arrin në përfundimin që universiteti ndjek politikën e duhur për sa i përket studentëve të rinj të regjistruar, komunikimit me studentët dhe stafin, mbështetjes ndaj kategorive të veçanta shoqërore, dhe ofronit të literaturës dhe mbështetjes për studentët gjatë jetës së tyre akademike, kulturore dhe sportive në universitet.

Universiteti e ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerëson angazhimin e universitetit në këtë proces dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet që ai ka me universitetet italiane, të cilat lehtësojnë zhvillimin e aftësive teknike që nevojiten në Shqipëri e më gjerë, në Ballkan. (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi III.2**)
- burimet e shumta fizike për mësimdhënien dhe kërkimin, të cilat ofrojnë mundësinë e të nxënit gjithëpërfshirës praktik dhe empirik, të mbështetur nga një gamë shërbimesh për studentët (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi V.1**)
- synimin strategjik të universitetit për t'iu përgjigjur nevojave të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit, nëpërmjet identifikimit të mangësive në ofertat akademike dhe zgjidhjes së këtij problemi, duke hapur programe të reja (pika 3.4; **Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.4**)
- politika që universiteti ndjek, e cila iu mundëson studentëve shqiptarë njohjen e studimeve në Evropë, nëpërmjet pajisjes me diploma të përbashkëta me universitetet italiane (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- universiteti është një institucion që e ushtron veprimtarinë e tij në gjuhën italiane dhe është i hapur për studentët e huaj, veçanërisht për ata që vijnë nga Italia. (pika 5.1; **Kapitulli I Standardi II.1**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- ndërtimi i një spitali brenda korpusit, i cili parashikohet të vihet në funksionim në vitin 2018, si një burim i shkëlqyer për mësimdhënie dhe një aset i vlefshëm për persona nga i gjithë rajoni (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.3**)
- qasja mbarinstitucionale e universitetit për vlerësimin e kërkimit shkencor, gjë që përmirëson praktikën ekzistuese të planifikimit, rrit angazhimin për mbështetjen e atyre kërkimeve me rëndësi për vendin dhe Ballkanin, dhe përforcon qasjen e tij ndaj ndërkombëtarizimit të kërkimit (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë përbushur **plotësisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjes e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin Katolik, Standardet Shtetërore të Cilësisë **janë përbushur plotësisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Statuti i universiteti **[A13]** përcakton natyrën ligjore, misionin, strukturën organizative dhe funksionimin e institucionit në përputhje me ligjin. Ai përcaktohet si një institucion privat, jofitimprurës i arsimit të lartë që ushtron veprimtari në fushën e arsimit universitar dhe të kërkimit shkencor. Kjo mbështetet nga rregulloret e detajuara, **[A97]** të cilat përcaktojnë strukturën e fakultetit dhe të departamentit, drejtimin, përgjegjësitë, diplomat që lëshohen, pranimet, vlerësimet dhe diplomimin. Aktualisht Statuti **[A13]** dhe Rregullorja **[A97]** janë në proces përditësimi, për të reflektuar ligjin e ri të arsimit të lartë **[A2]**. Universiteti dhe programet e tij të studimit u akredituan për herë të parë në vitin 2007 nga Ministria, **[A95]** dhe më pas në vitin 2016. **[A96] [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Universiteti është i organizuar në përputhje me Statutin **[A13]** dhe Rregulloret **[A97]** për të garantuar efektshmërinë në drejtimin e institucionit. Drejtori i Përgjithshëm harton buxhetin, duke marrë në konsideratë nevojat e departamenteve për mësimdhënie, kërkim dhe shërbime. Më pas, buxhetet kalojnë për diskutim në Senat dhe për miratim përfundimtar nga Këshilli Drejtues. **[A2; M3; M7]** Pjesa më e madhe e buxhetit përdoret për të mbuluar shpenzimet për stafin akademik nga universitetet partnere italiane, të cilët punojnë në universitet, duke mundësuar lëshimin e diplomave të përbashkëta. **[A2, Turi]** Përcjellja e informacionit nga stafi, nëpërmjet departamenteve, të Senati, dhe qarkullimi i vendimeve të marra nga Senati për stafin dhe studentëve, realizohet me efikasitet. **[A2; M1; M2; M3; M4; M6; M7]**. Menaxhimi dhe drejtimi i universitetit, dhe proceset vendimmarrëse janë të efektshme dhe janë të qarta për stafin e të gjitha niveleve. **[M3; M6; M7] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Struktura e universitetit, siç përcaktohet në Statut **[A13]** dhe në Rregullore **[A97]** është i disponueshëm për publikun **[A99]**. Përveç Senatit **[A18]** dhe Këshillit ose Bordit Drejtues, **[B2]** universiteti ka disa komisione dhe këshilla të tjera. Këtu përfshihet Këshilli i Etikës **[A14; A15; B18; B38]**, Komisionet e Përbashkëta të Mësimdhënies **[A16; B14]** dhe Këshilli i Profesorëve **[A16]**. Komisioni i Përbashkët i Mësimdhënies është i barasvlershëm me strukturën e Këshillit të Fakultetit në universitete të tjera, dhe përbëhet nga anëtarë të universiteteve italiane, si Universiteti i Barit, i Romës dhe i Firences **[A26; A31; A101]**. Kjo është një lidhje e rëndësishme që lejon krahasueshmërinë e mënyrës së ofrimit të programeve dhe vlerësimin me universitetet italiane, si dhe lëshimin e diplomave të përbashkëta **[M1]**. Rolet dhe përgjegjësitë e stafit kryesor të universitetit, si ato të dekanit dhe përgjegjësvë të departamenteve, përcaktohen në Statut **[A13]** dhe në Rregullore **[A97]**. Stafi, me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, **[M1; M2; M3; M6; M7]** pohoi informimin dhe përfshirjen në vendimmarrje. Struktura e drejtimit funksionon me efikasitet dhe eficiencë, duke përkrahur debatin konstruktiv. **[Kapitulli III Standardi I.2; Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 Universiteti garanton respektimin e kufijve të autonomisë së tij dhe ushtrimin e veprimtarisë brenda ligjit dhe rregulloreve. Auditimi financiar kryhet në mënyrë të pavarur nga një auditues i caktuar nga Fondacioni **[A2; A102]**. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë **[A82; A83; B19; B25]** verifikon administrimin e universitetit dhe veprimtarive të tij. Njësia përgatit një raport vjetor (shihni pikën 4.3) për Rektoren dhe Senatin, dhe propozon ndryshimet që mund bëhen në Rregullore. Universiteti ka ngritur një Zyrë për Projektet e Kërkimit dhe Koordinimin Ndërkombëtar **[A2; M7]** për të përfutur nga financimet e disponueshme të programeve evropiane e më gjerë (shihni pikën 4.7). **[Kapitulli III Standard I.4]**
- 1.5 Universiteti ka një plan afatmesëm dhe afatgjatë zhvillimi, **[A19; C10]** ku objektivat e synuara janë në përputhje me misionin e tij dhe mbështeten në zbatimin e marrëveshjes

ndërmjet Kishës Katolike dhe Qeverisë Shqiptare [A5]. Ky plan përfshin programet, strukturën organizative dhe infrastrukturën, si p.sh. ndërtimin e një spitali të ri në korpusin e universitetit në Tiranë. Plani është përditësuar së fundmi [B12] dhe pasqyron informacione më të sakta rreth programeve të ofruara dhe numrit të parashikuar të studentëve. Këto plane zhvillimi janë miratuar nga Senati dhe Këshilli Drejtues, [A2] janë diskutuar gjerësisht brenda departamenteve [M6, M7] të universitetit, dhe janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. **[Kapitulli III Standard I.5]**

1.6 Raporti Vjetor [A20] pasqyron veprimtarinë e brendshme dhe të jashtme të universitetit gjatë gjithë vitit. Ai shërben për të vlerësuar ecurinë në krahasim me planin e zhvillimit dhe përmban të dhëna rreth çdo fushe të universitetit [A2]. Senati miraton Raportin Vjetor, i cili më pas dorëzohet në ministri. Stafit akademik dhe studentët mund ta aksesojnë atë në bibliotekë. **[A2][Kapitulli III Standard I.6]**

1.7 Sipas nenit 7 të Statutit, universiteti gëzon autonomi dhe liri akademike të plotë në mësimdhënie dhe kërkim akademik [A13]. Këtu përfshihen: liria për të zgjedhur vetë stafin akademik, oferta e programeve të studimit, krijimi i partneriteteve me universitete dhe organizata të tjera, pranimi i studentëve, dhe përdorimi i truallit dhe pasurive të tjera të Fondacionit. Aktualisht, universiteti ka katër fakultete të ndara në 10 departamente, duke përfshirë edhe filialin në Elbasan [A99]. Komisionet e Përbashkëta Teknike dhe Mësimdhënëse janë një komponent shtesë i rëndësishëm për strukturën normale që kanë zakonisht universitetet, dhe janë një organ i rëndësishëm vendimmarrës për çështje që lidhen me menaxhimin e programeve të përbashkëta me universitetet italiane [A2; M3]. Universiteti ka ngritur edhe struktura të tjera, si Qendra Ndërkombëtare për Kërkim dhe Studim, Zyra e Informimit Evropian, Qendra për Formimin e Deputetëve të Evropës Juglindore, Observatori i Sistemeve Shëndetësore të Ballkanit dhe Qendra Evropiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim, të cilat janë pjesë e strukturës së universitetit me funksione të posaçme, që kryejnë kërkim të specializuar. Diploma Bachelor në Infermieristikë është programi i vetëm që ofrohet aktualisht në Elbasan, për të përmbushur një nevojë vendase. [M4; M6]. Universiteti ka një faqe gjithëpërfshirëse interneti [www.unizkm.al] që ofrohet në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, ku renditen dhe përshkruhen të gjitha programet e ofruara për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve. **[Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi II.3]**

1.8 Universiteti, në kuadër të studimit të tregut, konsultohet me palët kryesore të interesit, si Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri [A42; M5] lidhur me aftësitë që nevojiten në rajon, dhe i ka identifikuar ato, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe më gjerë për rajonin e Ballkanit [M3; turi]. Gjithashtu, ai ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me dy universitete të tjera në Shqipëri, një ndër këtyre është Universiteti i Tiranës [A33]. Nga pothuajse 2000 studentë që ndjekin studime me kohë të plotë, 439 janë italianë, ndërsa shumica e të tjerëve janë me nënshtetësi shqiptare. [A1]. Të gjitha programet ofrohen në italisht, dhe pjesa më e madhe e stafit akademik me kohë të plotë janë italianë, bashkë me gjysmën e stafit akademik me kohë të pjesshme [A1; M2; M6]. Universiteti monitoron punësimin e të diplomuarve si në Shqipëri, ashtu dhe në Itali, dhe raporton një nivel të lartë punësueshmërie [M7], ku një pjesë e mirë e të diplomuarve plotësojnë boshllëqet e atyre aftësive që nevojiten në tregun shqiptar. **[Kapitulli III Standardi III.1]**

1.9 Bashkëpunimi me universitetet në Itali është pjesë e strategjisë afatgjatë të universitetit, ku marrëveshje bashkëpunimi janë lidhur me Universitetin e Romës [A26], Universitetin e Milanos [A29], Universitetin e Firences [A30; A31] dhe Universitetin e Barit [A101]. Studentët e universitetit studiojnë programe të njëjta me ato të universiteteve italiane dhe pajisen me një diplomë të përbashkët, nga Universiteti Katolik dhe Universiteti partner Italian [M1]. Studentët marrin pjesë në stazhe në Itali dhe në Shqipëri, të cilat organizohen nga universitetet italiane. Universiteti ka lidhur marrëveshje me disa spitale në Shqipëri për zhvillimin e stazheve [A27; A28]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon si

karakteristikë të **praktikës së mirë** lidhjet që UniZKM-ja ka me universitetet italiane, të cilat lehtësojnë zhvillimin e aftësive teknike që nevojiten në Shqipëri e më gjerë. **[Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3]**

- 1.10 Zyra për Projektet e Kërkimit dhe Koordinimin Ndërkombëtar, ashtu si edhe Koordinatorët e Programeve, luan një rol të rëndësishme në koordinimin e marrëveshjeve me partnerët italianë **[M7]**. Rreth 20 për qind të studentëve kanë qenë jashtë vendit në kuadër të programit të tyre të studimit **[Anketimi i Studentëve]** dhe kjo pasqyron faktin që, p.sh. studentët e mjekësisë mbulojnë 60% të programit të tyre të studimit për vitin e 6-të në stazhin që kryejnë në Itali. Numri i madh i stafit mësimdhënës italian, që vijjnë në universitet për t'u angazhuar në mësimdhënie dhe për të përmbushur nevojat e kërkimit shkencor, ofron shërbim në disa lëndë specifike dhe akomodohet në godina të posaçme. **[turi][Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet që ai ka me universitetet italiane, të cilat lehtësojnë zhvillimin e aftësive teknike që nevojiten në Shqipëri e më gjerë, në Ballkan. (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi III.2**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti ndjek politika të qarta dhe të hapura të burimeve njerëzore për rekrutimin dhe punësimin e personelit, të cilat përbushin kriteret rregullatore sipas Rregulloreve të Brendshme. Politikat dhe procedurat mbështesin procesin e konkurrimit për punësimin e stafit të kualifikuar me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të plotësuar kriteret akademike dhe administrative të universitetit. Struktura organizative është e qartë, dhe publikohet në faqen e internetit të universitetit [<http://www.unizkm.al>]. Departamenti i Burimeve Njerëzore publikon vendet e lira të punës, dhe kriteret e punësimit për palët e interesuara publikohen në faqen e internetit. Procedura e punësimit për stafin administrativ është e njëjtë edhe për stafin akademik dhe mbështetet te Kodi i Punës [A13; A97; M7]. Stafi akademik punësohet sipas ngarkesës mësimore. [A13; A97; A35; A36; A2 p18; M1; M2]. Stafi akademik përbëhet nga pedagogë shqiptarë dhe italianë. I gjithë stafi i ri akademik përkrahet në ndjekjen e studimeve të doktoraturës pranë një universiteti italian. Personeli teknik dhe stafi akademik mbështetës përkrahen që të marrin pjesë në formime të mëtejshme [A13; A97; A2 fq. 18; M1; M2; A34; A41; B22]. **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**
- 2.2 Universiteti angazhohet në integrimin e personelit akademik dhe administrativ nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, ata angazhohen në aktivitete të ndryshme, si ditët e hapura, panairt për arsimin e lartë dhe aktivitetet festive. Universiteti synon punësimin e stafit akademik të kualifikuar kombëtar dhe ndërkombëtar. Stafi i fakultetit përkrahet të punojë në projekte me financim të jashtëm për promovimin e mobilitetit ndërkombëtar. [A2 p20; <http://unizkm.al/>; C1; C11; M1; M2; M3; M6][**Kapitulli III Standardi IV.2**]
- 2.3 Universiteti ka disa procedura për vlerësimin e efikasitetit të stafit akademik. Çdo vit organizohen aktivitete formuese, ku merr pjesë i gjithë stafi përkatës. Universiteti ka metoda të posaçme për vlerësimin periodik të performancës së stafit. Këtu përfshihen: vlerësimi nga Rektorati dhe Dekanati, mbledhjet vjetore për shqyrtimin e punës kërkimore dhe akademike, dhe raportet vjetore për performancën akademike dhe kërkimore në nivel departamenti. Secili anëtar i stafit akademik plotëson një formular për vetëvlerësimin mbi performancën kërkimore dhe akademike, që dorëzohet në fund të çdo viti akademik. Përpara sezonit të provimeve, studentët plotësojnë pyetësorë për vlerësime vjetore rreth mënyrës së ofrimit të programeve dhe performancës së pedagogëve, të cilët shërbejnë për marrjen e vendimeve mbi ndryshimet që duhen bërë vitin pasardhës. [A2, fq.20; M1; M3; M4; M6; C20][**Kapitulli III Standardi IV.3**]
- 2.4 Universiteti angazhohet në aktivitete komunitare dhe integruese për stafin dhe studentët. Stafi dhe studentët pohojnë se aktivitetet e organizuara bashkërisht, si panairt e punës, aktivitetet sociale dhe konkurset sportive, kanë ndihmuar në integrimin në komunitetin universitar. Në vit organizohen dy ose tre aktivitete që promovojnë debatin social, për shembull Përrurimi i Vitit Akademik, Aktivitetet e Fondacionit dhe mbështetja për nismat sociale lidhur me vullnetarizmin. Universiteti ndjek politika për sigurimin e jetës në përputhje me standardet evropiane [A2 p20-21; <http://unizkm.al/>; B29; C21]. Për rrjedhojë, universiteti kryen një menaxhim efikas të burimeve njerëzore. [A2 fq. 21; M1; M3; M6; B22; B36; B47][**Kapitulli III Standardi IV.4**]
- 2.5 Universiteti, duke marrë parasysh ligjin për arsimin e lartë dhe rregulloret e tij, ka një sistem efikas për menaxhimin financiar dhe përgatitjen e buxhetit vjetor. Buxheti vjetor diskutohet dhe miratohet nga Këshilli Administrativ, duke llogaritur buxhetet për secilin departament. Universiteti ndjek procedura transparente për menaxhimin e burimeve financiare. Menaxhimi financiar realizohet, duke respektuar kriteret statutorë, sipas të cilave buxheti i dërgohet çdo vit Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Buxheti i delegohet çdo fakulteti në mbështetje të zbatimit të prioritetëve kryesorë. Kërkesat e departamenteve

dhe fakulteteve shqyrtohen nga Senati dhe Bordi Drejtues, dhe më pas miratohen nga Rektorati. Universiteti garanton respektimin e standardeve vendase të kontabilitetit. Pasqyrat financiare i dorëzohen Zyrës së Tatimeve dhe dokumentet ruhen sipas legjislacionit përkatës. **[A2 fq. 21-22; A13; A97; A102; B28; M3; M4][Kapitulli III Standardi VI.1;Kapitulli III Standardi VI.2;Kapitulli III Standardi VI.3]**

- 2.6 Universiteti ka një sistem informacioni, dhe së fundmi është pajisur me një certifikatë për sigurinë e informacionit, konkretisht ISO 27001. Koordinimi dhe zbatimi i politikave realizohet me anë të sistemeve mbështetëse për menaxhimin e rrjedhës së punës. Universiteti publikon në faqen e tij të internetit të gjitha informacionet që mund të kërkojë publiku. Kuadri për menaxhimin e sistemeve të informacionit të universitetit përcaktohet në rregulloren përkatëse. Infrastruktura e menaxhimit të informacionit ka në të një Sistem për Menaxhimin e Studentëve, dhe një bazë të dhënash për regjistrimin e studentëve dhe rezultatet e provimeve. Sistemi i studentëve ofron online planet mësimore, informacione rreth kurseve, datat e provimeve dhe materialet mësimore. Faqja e internetit përmban informacione standarde rreth veprimtarive institucionale, akademike, kulturore dhe shoqërore. **[A2 fq.23;<http://unizkm.al/>; M2; M3, M4; M6; M7; C16].***[Kapitulli III Standardi VII.1]*
- 2.7 Universiteti ka një infrastrukturë të përshtatshme të teknologjisë së informacionit, e cila i përmbush nevojat e stafit dhe studentëve. Interneti dhe Wi-Fi janë të disponueshme në të gjithë universitetin. Universiteti ka disa laboratorë praktike të pajisur me instrumente moderne të specializuara, për t'i mbështetur studentët gjatë mësimdhënies. Përveç kësaj, auditorët janë të pajisur me mjete moderne elektronike të mësimdhënies dhe sallat e mësimit kanë mjaftueshëm kompjutera për t'iu përgjigjur më së miri nevojave të studentëve. Kohët e fundit, këto shërbime janë integruar me paketën për Arsimin "Google Apps". **[A2 fq. 23-24;<http://unizkm.al/>; M2; M3; M4; M6; M7; C16; Turi]***[Kapitulli III Standardi VII.2]*
- 2.8 Pasuritë e paluajtshme menaxhohen drejtpërdrejtë nga Bordi i Drejtuesve të Fondacionit dhe Presidenti. Universiteti ka vërtetuar që ndër vite Fondacioni i ka shtuar programet dhe strukturat e universitetit, dhe ka rinovuar shumë godina në aspektin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimore në fushën e shëndetësisë në Shqipëri, si laboratorit i fizioterapisë brenda korpusit dhe klinika në qytetin e Tiranës. Aktualisht, Fondacioni po ndërton një spital brenda korpusit, i cili parashikohet të vihet në funksion në vitin 2018, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** që ky projekt shërben si një burim shumë i mirë për mësimdhënie dhe një aset i vlefshëm për persona nga i gjithë rajoni **[A2 fq. 23; A44; A45; A46; B24; M7; Turi].***[Kapitulli III Standard VII.3]*
- 2.9 Universiteti promovon trashëgiminë e tij akademike dhe shkencore, dhe kulturën në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë. Ai ruan dhe regjistron të gjithë dokumentet zyrtare në përputhje me kërkesat ligjore. Departamentet e Protokollit dhe Arkivit, Teknologjisë së Informacionit dhe Burimeve Njerëzore mbledhin dhe kanë përgjegjësi të posaçme për ruajtjen e dokumentacionit përkatës në format elektronik dhe të shtypur **[A2 fq. 24-25; M1; M7].***[Kapitulli III Standardi VII.4]*
- 2.10 Infrastruktura, laboratorët me pajisje moderne, stafi akademik i kualifikuar dhe me përvojë, dhe lidhjet e duhura me tregun e punës ndihmojnë në realizimin me efikasitet të veprimtarive të universitetit. Struktura logjistike dhe administrative i përmbush kriteret e legjislacionit shqiptar. Profesionistët e universitetit menaxhojnë departamentin teknik dhe logjistik dhe bashkëpunojnë me zyrën e prokurimeve për të ofruar shërbime të interesit të përbashkët **[A2 fq. 25-26; A44; A45; A46; C10; M7; Tur].***[Kapitulli III Standardi VII.5]*

- 2.11 Universiteti ka korpusin dhe godinat e tij në Tiranë **[A2 fq. 25-26; Turi]**. Përgjegjësia për menaxhimin e burimeve dhe strukturave shprehet qartësisht në Statutin dhe Rregulloret e universitetit. Bordi i Drejtuesve të Fondacionit dhe Presidenti janë përgjegjës për pasuritë e paluajtshme. Universiteti ka strukturat e duhura për të përmbushur kriteret statutores dhe ato të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon si karakteristikë të **praktikës së mirë** nivelin e lartë të burimeve fizike të ofruara për mësimdhënien dhe kërkimin, të cilat ofrojnë mundësinë e të nxënies gjithëpërfshirës praktik dhe empirik, të mbështetur nga një gamë e gjerë shërbimesh për studentët. Këtu përfshihen: një laborator kompjuterik, klinika dhe laboratori dentar, laboratorët e anatomisë, histologjisë, fizioterapisë dhe kimisë, një sallë operacionesh, klinika rehabilituese dhe një pishinë hidroterapi. Përveç këtyre, universiteti brenda strukturës së tij ofron edhe një sallë konferencash, disa auditorë, një bibliotekë qendrore, mensën, rrjetin Wi-Fi dhe infrastrukturë plotësisht të aksesueshme për studentët me aftësi të kufizuara fizike. Universiteti ofron akomodim për 35 pedagogë të stafit akademik që vijnë nga Italia. **[A13; A97; M2; M3; M7][Kapitulli III Standardi VII.6; Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.12 Të gjitha dokumentet përkatëse ruhen në format elektronik dhe të shtypur në përputhje me kriteret ligjore. Sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit përdoret për të mbledhur dhe për të ruajtur materialet në format elektronik dhe për t'i raportuar rregullisht Agjencisë së Akreditimit dhe Ministrisë **[A2 fq. 27-29; A20; M7; Turi]** **[Kapitulli III Standardi V.2]**
- 2.13 Universiteti ruan dokumentacionin e plotë rreth veprimtarisë akademike në format elektronik dhe të shtypur. Studentët e rinj regjistrohen në bazën e të dhënave të studentëve, në përputhje me formatin e miratuar nga Ministria. Universiteti i menaxhon këto nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (UniMS) dhe nëse nevojitet i ruan të dhënat edhe në format të shtypur. Ai ruan statistikën rreth statusit të studentëve, regjistron historikun e veprimeve dhe pyetësorëve, dhe informacione financiare dhe menaxheriale. Të dhënat ruhen për më shumë se 10 vjet. **[A2 fq. 27-29; M2; M3; M4; M6; M7; Turi në korpus] [Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- burimet e shumta fizike për mësimdhënien dhe kërkimin, të cilat ofrojnë mundësinë e të nxëniet gjithëpërfshirës praktik dhe empirik, të mbështetur nga një gamë shërbimesh për studentët (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi V.1**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- ndërtimi i një spitali brenda korpusit, i cili parashikohet të vihet në funksionim në vitin 2018, si një burim i shkëlqyer për mësimdhënie dhe një aset i vlefshëm për persona nga i gjithë rajoni (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.3**).

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Në përputhje me planet e zhvillimit të vazhdueshëm **[A19; C19; B12]**, universiteti ofron kualifikime në të tre programet e cikleve të studimit: katër programe Bachelor, katër Master të Nivelit të Dytë, tre Master Profesional, katër Master të Shkencave dhe dy doktoratura **[A12]**. Faqja e internetit publikon informacione në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze [<http://www.unizkm.al/en/>] mbi modulet e studimit, kreditet, praktikën profesionale dhe mundësitë e punësimit **[p.sh. <http://www.unizkm.al/en/didactic-offers/facolta-di-economia/bachelor-e-economics/320-political-sciences-and-international-relations>]**, si dhe kriteret përkatëse për praninë në programet e studimit **[C13; A105]**. Universiteti shpërndan fletëpalosje, ku përshkruhet çdo program studimi **[B30-B32]**. Procesi i pranimit përcaktohet zyrtarisht në Statutin **[A13section 33]**, Rregulloret **[A97 seksioni 17]** dhe udhëzuesit e programeve të veçanta, **[A56; B1]** që menaxhohen nga Zyra e Pranimeve **[M7]**. Universiteti mban vazhdimisht kontakt me shkollat e mesme anë të Ditëve të Hapura, Panairëve të Arsimit të Lartë dhe Ditëve të Orientimit të Karrierës **[A104]**. Për studentët që vijnë nga vendet anëtare të BE-së, universiteti përcakton dispozita specifike për pranimin **[A47; A105; M7]**. **[Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Universiteti ofron një gamë të gjerë veprimtarish të edukimit në vazhdim për praktikantët e profesioneve të ndryshme, shpesh të informuar nga projektet ndërkombëtare bashkëpunuese të zhvillimit **[A53 fq. 21-24; M4]**. Këtu përfshihen konferenca dhe seminare në mjekësi, stomatologji, infermieristikë, fizioterapi dhe farmaci **[A53 fq. 21-24; C1; C11]**, si dhe kurse të specializuara formimi, si mjekësia sportive **[C2]**, menaxhimi spitalor **[C3]**, simulimi i avancuar i kushteve mjekësore **[C4]** dhe nismat për Studimet e Paqes. **[A53 fq. 25-26]** **[Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 Rregulloret e programeve ofrojnë detaje rreth objektivave të të nxënësve, pranimeve, orareve mësimore dhe krediteve të moduleve, **[A60, A62, A63, A64]**. Përshkrimet e moduleve përmbajnë orët e mësimnxënies, kreditet, rezultatet e të mësuarit, përmbajtjen, vlerësimin dhe literaturën e rekomanduar **[A72-74]**. Politikat e vlerësimit parashtrihen në rregulloret e universitetit **[A97 §11]** dhe në rregulloren e secilit program **[A56; B1]**. Stafit akademik dhe studentët pohojnë se vlerësimi kryhet sipas qasjeve të diferencuara dhe se studentët marrin feedback të dobishëm që i lejon ata të përmirësojnë performancën **[M4; M6]**. Në përfundim të studimeve të tyre, studentët prezantojnë zyrtarisht një temë diplome **[A13 seksioni 13, seksioni 14; A56 fq. 19; C1 seksioni 9]**. Në përfundim të studimeve të tyre, studentët pajisen me një diplomë të dyfishtë, një nga universiteti i tyre dhe një nga universiteti italian partner **[A50, M4]**, e cila ka dhe një suplement diplome **[A97 seksioni 13; A79]**. **[Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.6; Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.4 Misioni i universitetit përqendrohet në zhvillimin e arsimit universitar për profesionistë që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë **[A13 seksioni 4]**. Misioni formulohet mbi politikat kombëtare për ndërkombëtarizimin, dhe zhvillimin e infrastrukturës ekonomike dhe shërbimeve mjekësore. Kjo garanton koherencën e planeve të zhvillimit të programeve që parashikohen te Planet e Zhvillimit **[A19; C19; B12]**. Një element i rëndësishëm i zhvillimit strategjik të shërbimeve mjekësore është ndërtimi i spitalit universitar, ideja për të cilin lindi nga një marrëveshje e lidhur në vitin 1993 ndërmjet Kishës Katolike dhe Qeverisë së Shqipërisë **[A5; B12 fq. 4; M1; M4; M5; Turi]**. Objektivat akademike arrihen nëpërmjet lëshimit të diplomave të përbashkëta me universitetet italiane **[A12]** dhe zhvillimit të programeve në gjuhën italiane **[A13 seksioni 8.4]** nga staf i kualifikuar në Itali **[A86-A91]**. Zotërimi i gjuhës italiane në nivel të avancuar përbën kriter pranimi për studentët **[A105]**. Në përputhje me planet e zhvillimit të vazhdueshëm **[A19; C17; B12]** dhe misionin e universitetit, për ta vënë

“shkencën në shërbim të njerëzve” **[A13 seksioni 4]**, pothuajse të gjitha programet e universitetit përbëjnë fusha të reja studimi në Shqipëri, të cilat janë të hartuara për t’iu përgjigjur aftësive të munguara në nivel kombëtar dhe në rajonin e Ballkanit; për shembull, një program Master i Nivelit të Dytë i hartuar posaçërisht për të trajtuar mungesë e identifikuar për menaxherë të shërbimit shëndetësor, i cili përqendrohet në menaxhimin strategjik të shërbimeve shëndetësore dhe mbështetet në bashkëpunim ndërdisiplinor ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë dhe atij të Ekonomisë, si edhe evidenton punën e Observatorit të Sistemeve Shëndetësore të Ballkanit [\[http://www.unizkm.al/al/korpusi/organigrama/258-observatorit-i-sistemeve-sh\]](http://www.unizkm.al/al/korpusi/organigrama/258-observatorit-i-sistemeve-sh); një program Master Profesional në “Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit” i hapur për të mbështetur industrinë e re të turizmit në Shqipëri; një program Doktorature në “Shëndet Publik, Diagnozë Molekulare të Sëmundjeve Infektive dhe Farmakovigjilancë”, i cili mbulon fushat strategjike që nevojiten në kujdesin shëndetësor **[B12; M3; M4; Turi]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikon si karakteristikë të **praktikës së mirë** fokusin e universitetit për t’iu përgjigjur nevojave të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit, nëpërmjet identifikimit të mangësive në ofertat akademike dhe zgjidhjen e këtij problemi, duke hapur programe të reja. **[Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.4]**

- 3.5 Përgjegjësi i departamentit bie dakord me çdo pedagog për ngarkesën mësimore lidhur me mësimdhënien, administrimin dhe kërkimin **[A2 fq. 34; A25 seksioni 24]**. Akademikët pohuan se procesi është efikas dhe se mësimdhënia zë zakonisht 30-40 për qind të punës së tyre **[M6]**. Çdo orë mësimi shtesë paguhet nga Fondacioni i universitetit. **[A2 fq. 35] [Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.6 Programet e ciklit të parë ofrojnë njohuri bazë rreth metodave dhe parimeve të përgjithshme shkencore, zhvillojnë aftësitë profesionale me anë të praktikave laboratorike dhe stazheve, dhe janë të hartuara në mënyrë të tillë që t’i përgatisin studentët për studimin e ciklit të dytë dhe për punësim **[p.sh. B1 seksioni 2]**. Nëpërmjet lëshimit të titujve italianë të studimit, universiteti përmbush me sukses Procesin e Bolonjës; programet e studimit ofrohen në tre cikle: Bachelor, Master (përfshirë Masterin e Integruar në Stomatologji, Mjekësi dhe Arkitekturë) dhe doktoraturë **[A97 seksioni 10.5-6]**. Kjo do të thotë që struktura e programeve të studimit është e qartë edhe për studentët e huaj. Në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), caktohen kushtet për transferimin e krediteve të studentëve për në këtë universitet dhe nga universiteti **[A97 seksionet 18-19; A51 seksioni 4]. [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.7 Studentët e ciklit të parë marrin pjesë në një program orientimi, i cili i njeh ata me universitetin, shërbimet mbështetëse, syllabusin e programit dhe orarin mësimor **[A2 fq.37]**. Mbështetja që i ofrohet studentëve gjatë programit të studimit të studentëve sigurohet me anë të një sistemi tutoriat **[M4]** dhe koordinatoreve të programit **[A97 seksioni 6; M3; M4]**, që janë akademikët, të cilët mbikëqyrin administrimin e programit për të garantuar që studentët ta kuptojnë mësimdhënien në italisht dhe sigurojnë vazhdimësinë gjatë mungesës së tutorëve italianë. Më shumë se 70 për qind e stafit akademik të ciklit të parë punojnë me kohë të plotë **[A2 fq.38]**. Studentët pohojnë efikasitetin e orientimit fillestar, qartësinë e informacionit të marrë, efikasitetin e sistemit të tutoriatit dhe koordinatoreve të programeve **[M4]**. Së fundmi, universiteti ka krijuar një Zyrë për Këshillim dhe Orientim të Karrierë, e cila funksionon si një qendër me një ndalesë të vetme, që mbulon çështjet që lidhen me studentët **[M7]**, dhe sipas vlerësimit të studentëve, qendra ishte efikase, si p.sh në rastin e këshillimit të karrierës **[M4]**. Siç theksohet dhe në Strategjinë e Zhvillimit 2010-2017 **[C17]**, vëmendje e veçantë i kushtohet prezantimit të metodologjive të reja të mësimdhënies. Për shembull, në Fakultetin e Mjekësisë, metodat aktive të të mësuarit janë mjaft të përparuara, si p.sh: studentët kanë mundësi të angazhohen me praktikën e fizioterapisë në “terren”, duke

përdorur një pishinë hidroterapi, në fushat prioritare të diagnostikimit mjekësor, shërbimin mjekësor të urgjencës dhe kirurgjinë dentare, dhe kanë integruar simulime në kompjuter, ku vlerësimi kryhet online përmes pyetjeve me alternativa. **[M1; M6; Turi]***[Kapitulli I Standardi I.8]*

3.8 Studimet e ciklit të dytë përfundojnë me temën e diplomës, e cila udhëhiqet nga stafi akademik i angazhuar me kërkimin dhe transferimin e njohurive, shpesh dhe me bashkëpunimin me partnerët e biznesit **[M4; M5; M6]**. Më shumë se dy e treta e stafit akademik vijnë nga universitetet italiane dhe kanë krijuar profile profesionale në fusha si mjekësia dhe farmacia, me interesa të larta në kërkim dhe pjesëmarrje në konferenca **[A86-A58]**. Në total, më shumë se 70 për qind e stafit të ciklit të dytë janë të punësuar me kohë të plotë **[A2 fq.38]**. Ruhen të dhënat statistikore mbi punësimin e të diplomuarve, dhe sipas një anketimi të fundit, nga 1400 studentë të diplomuar që prej themelimit të universitetit, 80 për qind ose ishin të punësuar ose ndiqnin studimet e larta, 11 për qind ishin të papunësuar dhe 9 për qind nuk kishin kthyer përgjigje. **[B10]***[Kapitulli I Standardi I.9]*

3.9 Përveç studimit të gjuhës italiane, studentët mësojnë gjuhën angleze gjatë ciklit të parë të studimeve **[B1]**. Një veçori e këtij universiteti është ofrimi i diplomave të përbashkëta në partneritet me universitetet italiane. Kjo promovon mobilitetin falë përmirësimit të aftësive në gjuhën italiane dhe ofron mundësi për zhvillimin e stazhit në Itali, duke iu mundësuar studentëve akses në tregun e punës në Itali, por gjithashtu bën të mundur që studentët të marrin akreditim profesional që u njihet nga gjithë punëdhënësit në Evropë, p.sh në farmaci, mjekësi dhe stomatologji. Punëdhënësit u shprehën se një element shtesë i këtyre të diplomuarve është njohja e mirë e kulturës italiane **[M5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikon si karakteristikë të **praktikës së mirë** praktikën e universitetit që iu mundëson studentëve shqiptarë njohjen e studimeve të tyre në Evropë, përmes diplomave të përbashkëta me universitetet italiane. *[Kapitulli I Standardi I.10]*

3.10 Programet e studimit janë të strukturuar në formë të tillë që të mundësojnë zbatimin e koncepteve me anë të praktikës profesionale. Studentët, stafi akademik dhe punëdhënësit pohojnë që ky proces është efikas **[M3; M4; M5; M6]**; për shembull studentët e fizioterapisë, në përfundim të stazhit të tyre në Itali kryejnë praktikën profesionale falë një rrjeti të krijuar nga universiteti me spitale shqiptare, duke përfshirë dhe vetë klinikën e universitetit. **[M6]**. Universiteti i mbështet shumë veprimtaritë shoqërore, duke përfshirë konferencat si ajo për Paqen dhe Familjen; festën vjetore për Fondacionin; vullnetarizmin; dhe aktivitete sportive, si turneu i futbollit. **[A2 fq. 20; A29; M4]** *[Kapitulli I Standardi I.11]*

3.11 Përgatitja për punësim arrihet pjesërisht me anë të moduleve të dedikuara të studimit; për shembull, programet Bachelor në Infermieristikë dhe në Fizioterapi përfshijnë një modul të posaçëm për biznesin **[A2, fq. 40]**. Megjithatë, metoda kryesore janë përdorimi i veprimtarive të mbështetura në praktikë, duke përfshirë leksionet praktike në laborator, si p.sh në Farmaci **[A56 fq.3, Shtojca A]**; simulimet kompjuterike në Fakultetin e Mjekësisë **[M1; M6; Turi]**; pjesëmarrja e studentëve të Fakultetit të Ekonomisë në konferenca dhe seminare **[A2 fq. 40]**; praktika e fizioterapisë “në terren” me pacientët në klinikën e universitetit, duke përdorur pishinën e hidroterapisë **[Turi]**; realizimi i projekteve kërkimore në bashkëpunim me stafin, p.sh. në stomatologji dhe anestezi **[M6]** ose me sektorin e industrisë, për shembull kërkime doktorature në farmaci **[M5]**; dhe zhvillimi i stazhit për të gjitha disiplinat, të cilat vlerësohen me notë dhe marrin kredite, sipas kushteve të caktuara në rregulloret e fakultetit **[A75-77 seksioni 17]**, një shembull është viti i gjashtë i stazhit mjekësor që kryhet në Itali **[M6]**. Studentët dhe dekanët u shprehën se stazhet në Itali janë veçanërisht të vlerësuara **[M3; M4]**. Të diplomuarit nga programet me diploma të përbashkëta me universitetet italiane janë të kualifikuar të punojnë si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali. *[Kapitulli 1 Standardi I.12]*

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- synimin strategjik të universitetit për t'iu përgjigjur nevojave të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit, nëpërmjet identifikimit të mangësive në ofertat akademike dhe zgjidhjes së këtij problemi, duke hapur programe të reja (pika 3.4; **Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.4**)
- politika që universiteti ndjek, e cila iu mundëson studentëve shqiptarë njohjen e studimeve në Evropë, nëpërmjet pajisjes me diploma të përbashkëta me universitetet italiane (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Në fund të çdo viti akademik, universiteti mbikëqyr një proces vlerësimi për programin mbështetur në reagimet e përfuara nga pyetëtorët e studentëve të plotësuar përpara provimeve përfundimtare të vitit akademik [A2 fq. 42; A80; C20; M2; M3; M4]. Gjithashtu, programet përditësohen sipas sugjerimeve të marra nga feedback-u i punëdhënësve [M5] ose kërkesave të universiteteve partnere italiane [A2 fq. 42]. Ky proces fillon në nivel programi dhe drejtohet nga koordinatorët e programeve. Vlerësimi i programit merr parasysh kërkesat e punës praktike, p.sh. në laborator, udhëheqja e temës së diplomës dhe praktika profesionale, duke garantuar mjaftueshmërinë e burimeve. Ky vlerësim mbulon planifikimin e ngarkesës së punës, me qëllim realizimin e mësimdhënies, por duke iu lënë akademikëve hapësirë të mjaftueshme për t'u angazhuar me punë kërkimore dhe administrative [A2 fq. 18; M5]. Rezultatet pasqyrohen në dokumentet dhe planet mësimore të përditësuara të programeve [A2 fq. 42; M7], për shembull ndryshimet në datat e provimeve të stomatologjisë, për të mos pasur më shumë se një provim në ditë [B34]. Të nxitur nga komunikimi i vazhdueshëm me Bibliotekarin, stafi akademik rekomandon përditësimin e stokut të bibliotekës, për të përmbushur nevojat kërkimore dhe të mësimdhënies [M7], dhe për të shtuar koleksionet ekzistuese (shihni pikën 5.6). *[Kapitulli I Standardi II.1]*
- 4.2 Rregulloret përcaktojnë udhëzimet dhe rregullat e përgjithshme të universitetit për provimet [A97 seksioni 11]. Këto shtjellohen gjerësisht në rregulloret e secilit program, mbështetur në rregulloret e programit të universitetit partner italian [A60-A64; A75-A77]. Studentët pohojnë që ky është një dokument i qartë nga i cili marrin informacione [M4]. Në të përshihen rregulloret e provimeve, dhe protokollet dhe kriteret për temën e diplomës dhe mbrojtjen e saj. Sipas anketimit të studentëve të kryer nga APAAL-i, 50 përqind e studentëve janë të mendimit se studentët kopjojnë në provime. **[Anketimi i Studentëve, P.9.iii]**. Megjithatë, studentët theksuan faktin që rregullat e provimeve ishin të rrepta, ndër të cilat është rregulli që pajisjet elektronike nuk lejohen brenda sallës së provimit [M4]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e pranoi argumentin, por duke marrë parasysh se pjesëmarrja e studentëve në anketim ishte vetëm 11 për qind. Studentët kanë të drejtë ta ankimojnë notën e një provimi. [A97 seksioni 22]. Ankimimi duhet kryer brenda 24 orëve nga momenti i shpalljes së rezultateve. Dekani i delegon ankimimet për rishikim Përgjegjësit të Departamentit dhe një pedagog. Më pas, përgjigja i dërgohet Dekanit, i cili merr vendimin përfundimtar [A97 seksioni 22]. Studentët i njohin rregullat e provimeve dhe procesin zhvillimit të temës së diplomës dhe ankimimit të notës, megjithatë ata pohuan që rrallëherë i ankimojnë notat, pasi vlerësimet e vazhdueshme e bënë që qartë nivelin e tyre të performancës, por u shprehën se koordinatorët e programeve ishin të disponueshëm për t'i diskutuar vlerësimet më provime edhe në rrugë jo zyrtare. [M4]. Siç u përmend dhe më sipër, studentët mbrojnë temën e diplomës për të përfunduar me sukses studimet e tyre [A97 seksionet 13-14; p.sh. A56 fq. 19; C1 seksioni 9], dhe pas diplomimit ata pajisen me një diplomë të dyfishtë, një nga universiteti i tyre, dhe një nga universiteti partner italian [A50; M4], i cili shoqërohet gjithashtu edhe nga suplementi i diplomës [A97 seksioni 13; A79]. *[Kapitulli I Standardi II.2]*
- 4.3 Që prej themelimit të tij, universiteti ka miratuar procese për vlerësimin e stafit, të cilat janë të ngjashme me ato të institucioneve partnere italiane, ndonëse të përshtatura në kontekstin e nevojave të universiteteve shqiptare. Këto realizohen kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve në fund të vitit, një prej të cilëve mbulon vlerësimin për secilin pedagog. Fakulteti i Mjekësisë përdor si tregues të mirë për secilin modul performancën e studentëve [M3]. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përpilon raporte të detajuara analitike për feedback-un e studentëve [A80] dhe të dhënat e punësimit të të

diplomuarve **[B10]**, të cilat diskutohen gjatë takimeve të stafit me studentët dhe Komisionet e Përbashkëta Teknike. Më pas, merren masat për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimxënies **[A2 fq. 44; M3]**. Si shembuj mund të përmendim rritjen e herëpashershme të cilësisë të arkitekturës **[B13]**; programimin më të mirë të orareve/datave të provimeve për studentët e fizioterapisë **[B16]**; dhe ndërmarrjen e procesit me anë të të cilit studentët vlerësojnë performancën e pedagogëve me kohë të pjeshme **[B17]**. Për më tepër, gjatë vitit akademik organizohen rregullisht mbledhje midis studentëve dhe koordinatorëve të programeve, gjë që lejon trajtimin e menjëhershëm të problemeve **[B16; B17]**. Studentët pohojnë që universiteti reagon gjithnjë e më shumë ndaj nevojave të studentëve, për shembull, duke iu përgjigjur kërkesave për më shumë literaturë në bibliotekë, ose data të tjera për kryerjen e provimeve jashtë sezonit. **[M4]/[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.4 Një nga detyrat kryesore që ka Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është ofrimi i mbështetjes për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies. Mbështetur në pyetësorët e studentëve **[A80]**, në rishikimin vjetor të programeve **[A2 p42]** dhe të dhënat e rezultateve të punësimit **[B10]**, kjo Njësi përgatit raportin vjetor **[A20]**, i cili rishikohet nga Rektori dhe Senati Akademik, **[A83]** rrjedhimisht edhe nga Ministra e Arsimit dhe Sportit. Shembuj të përmirësimeve që rrjedhin nga mënyra si i menaxhon kjo Njësi reagimet e studentëve janë: zhvillimi i kursit të gjuhës angleze për studentët e Fakultetit të Ekonomisë **[M3]** dhe pasurimi i stokut të bibliotekës **[M4]**. Përmirësimi sistematik arrihet edhe nëpërmjet pranisë së pedagogëve italianë, praktika e të cilëve përvetësohet nga tutorët dhe koordinatorët shqiptarë të programeve **[M3]**. Stafi italian vuri në dukje se marrëdhënia që ata kishin me universitetin i kishte lejuar të merrnin pjesë në debate rreth çështjeve akademike me kolegët e tyre shqiptarë **[M6]**. Për shembull, një Përgjegjës Departamenti në Fakultetin e Mjekësisë mbikëqyr personalisht mësimdhënien e pedagogëve të rinj dhe, kur është e nevojshme, jep feedback mbështetës **[M6]**; pedagogë të tjerë janë të angazhuar me pedagogjinë inovative, si në rastet e përdorimit të simulimeve në shërbimin mjekësor të urgjencës dhe vlerësimeve nëpërmjet kompjuterit me pyetje me alternativa **[M6]**. **[Kapitulli I Standardi II.4]**

4.5 Struktura e fakultetit të universitetit përbëhet nga tetë departamente dhe një qendër kërkimore, që përfaqësojnë njësitë bazë të mësimdhënies dhe të kërkimit. Këtu përfshihen Departamentet e Shkencave Kirurgjikale, Shkencave Mjekësore, Shkencave të Biomjekësisë (Fakulteti i Mjekësisë); Shkencave Farmaceutike, Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Vlerësim Farmakologjik dhe Kimiko-Toksikologjik i Medikamenteve (Fakulteti i Farmacisë; dhe Shkencave Ekonomike dhe të Biznesit, Strategjitë Bio-Ekonomike në BE dhe në Ballkan, Qendër Kërkimi për Ekonominë e Vendeve në Tranzicion (Fakulteti i Ekonomisë). Përveç këtyre, institucioni ka edhe Observatorin e Sistemeve Shëndetësore në Zonën e Ballkanit dhe Qendrën Evropiane të Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim **[A53 fq. 25-26]**. Raporti i Kërkimit (2015-2016) përcakton me hollësi punën që ka kryer çdo departament në pesë vitet e fundit me zhvillimin e axhendës së kërkimit **[A53]**. **[Kapitulli II Standardi I.1]**

4.6 Financimi për veprimtarinë kërkimore mbulohet nga Fondi Vjetor i Universitetit për Kërkimin (që miratohet nga Senati) **[A54 seksioni 2]** ose me anë të burimeve të financimit të jashtëm **[M3; M5]**. Njëri prej anëtarëve të stafit pohoi që universiteti kishte arritur të krijonte disa pozicione të përhershme të kërkimit **[M3]**. Për arritjen e objektivave të kërkimit ka qenë shumë i rëndësishëm bashkëpunimi, si në rastin e punës së Fakultetit të Farmacisë për kiminë, farmakologjinë, farmakovigjilancën dhe epidemiologjinë mjekësore që kërkonte partneritet me Institutin e Shëndetit Publik në Shqipëri dhe me Universitetin e Barit. **[Kapitulli II Standardi I.2]**

- 4.7 Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor është element përbërës i qasjes së universitetit, kjo për arsye se pjesa më e madhe e stafit akademik përbëhet nga akademikë italianë të kualifikuar në nivel doktorat në Evropë, gjë që hedh themelet për partneritete dhe bashkëpunime në të ardhmen **[A2 fq. 48]**. Akademikët italianë pohuan se pozicionet e tyre në universitet krijojnë mundësi për debate ndërdisiplinore, të cilat rrallëherë i kishin në universitetet e tyre të origjinës **[M3]**. Universiteti ka lidhur disa marrëdhënie bashkëpunimi me universitete të huaja, me të cilat ka bashkëpunuar për oferta të financimit të kërkimeve **[A26-A33]**. Që prej vitit 2012, janë ndërmarrë gjashtë projekte të suksesshme bashkëpunimi me universitete të huaja, p.sh një projekt i INTERREG MED, i cili trajtonte çështjen “Blue Growth” në Mesdhe dhe Projekti IADSA-s për përmirësimin e shëndetit nëpërmjet efikasitetit **[A53 fq. 18-20]**. Partneritetet promovohen edhe nëpërmjet punës së studentëve të doktoraturës **[A53 fq. 12-13]**. Stafi akademik pranoi që është bërë një punë e madhe për identifikimin e boshllëqeve në veprimtarinë kërkimore, për shembull, kërkimi në farmaci, si metodë për përgatitjen e një axhende kërkimore që do të rriste ndërkombëtarizimin **[M3]**. Stafi e ka realizuar kërkimin në më shumë se 100 konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare që prej vitit 2012 **[A53 fq.21-24; A86-A91]**; dhe departamentet organizojnë rregullisht konferenca, seminare dhe leksione të hapura;**[A2 p48]** si në rastin e Qendrës Evropiane të Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim, e cila organizon një shkollë verore të përvitshme rreth shkencës për paqe. **[Kapitulli II Standardi I.3;Kapitulli II Standardi I.7]**
- 4.8 Plani i Zhvillimit (2017-2027) parashtrohet axhendën kërkimore të universitetit, duke përfshirë shtimin e qendrave të reja të kërkimit. Për shembull, Departamenti i Shkencave Kirurgjikale ka vendosur prioritete të tjera shtesë pasi është përqendruar në kirurgjinë e përgjithshme, kirurgjinë onkologjike dhe prezantimit të teknikave të reja për kujdesin e traumës **[A53 p3]**. Që prej vitit 2017 e në vijim, departamenti do të shtojë në fokusin e tij edhe mjekësinë parandaluese dhe epidemiologjinë në Ballkan. Gjithashtu, Plani i Zhvillimit thekson se ndërtimi i një spitali të ri në vitin 2018 do të rrisë veprimtarinë kërkimore mjekësore dhe do t'i lërë hapësirë veprimtarisë trikahëshe në mësimdhënie, kërkim dhe inovacion për kujdesin ndaj pacientit. **[Kapitulli II Standardi I.4]**
- 4.9 Me qëllim përmbushjen në mënyrë të qëndrueshme të planeve të kërkimit të universitetit, Plani i Zhvillimit thekson rëndësinë e rekrutimit të stafit akademik shtesë të kualifikuar **[C17 fq. 4]**. Relacioni i detajuar i Raportit të Kërkimit, nëpërmjet kontributeve të bëra gjatë pesë viteve të fundit, tregon se sa i vlerëson universiteti kërkuesit e rinj **[A53 fq. 10-16; M5]**. Kërkuesit e rinj kanë kontribuar veçanërisht në zhvillimin e bashkëpunimeve me universitetet e huaja dhe me organet shkencore kombëtare. **[A53 fq. 13; M5][Kapitulli II Standardi I.6]**
- 4.10 Universiteti i përkrah departamentet duke organizuar seminare dhe simpoziume ndërkombëtare **[A53 fq. 21-24; C1; M6]**, duke botuar rezultatet e kërkimit shkencor të stafit **[A53 fq. 17; M6]** dhe duke mbrojtur pronësinë intelektuale me anë të patentave **[A2 fq.52; Turi]**. Institucioni e promovon kërkimin shkencor edhe nëpërmjet faqes së internetit të universitetit dhe me anë të rrjeteve sociale. **[Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8]**
- 4.11 Siç u theksua më sipër, në vitin 2016 universiteti nisi procesin e vlerësimit vjetor të veprimtarisë kërkimit dhe synon ngritjen e një njësie të posaçme që do të vlerësojë rregullisht ecurinë e rezultateve të kërkimit shkencor **[A2 fq. 53; M7]**. Planet për botimin e një reviste shkencore institucionale parashikohen për në një fazë të mëvonshme **[A2 fq. 53; M7]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se qasja mbarinstitucionale për vlerësimin e kërkimit shkencor, e cila zgjeron praktikën e tij ekzistues të planifikimit të kërkimit, angazhimin për të mbështetur kërkimet me rëndësi për vendin dhe Ballkanin, dhe qasjen e tij ndaj ndërkombëtarizimit të kërkimit. **[Kapitulli II, Standardi I.8]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- qasja mbarinstitucionale e universitetit për vlerësimin e kërkimit shkencor, gjë që përmirëson praktikën ekzistuese të planifikimit, rrit angazhimin për mbështetjen e atyre kërkimeve me rëndësi për vendin dhe Ballkanin, dhe përforcon qasjen e tij ndaj ndërkombëtarizimit të kërkimit. (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Procedura e pranimit të studentëve në programet e studimit zbatohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e universitetit [A2 fq. 54-55; A13; A97]. Informacioni për studentët e mundshëm dhe palët e tjera të interesit publikohen në faqen e internetit. Procesi i pranimit menaxhohet nga Zyra e Pranimeve, e cila koordinon të gjithë marketingun dhe komunikimet, shoqëruar nga orientimi i studentëve, turet dhe mbledhjet në korpus. Universiteti e ushtron veprimtarinë në gjuhën italiane dhe është i hapur ndaj studentëve të huaj, duke mirëpritur veçanërisht ata që vijnë nga Italia, dhe Grupi të Vlerësimit të Jashtëm, e konsideron si karakteristikë të praktikës së mirë. Për të lehtësuar integrimin e studentëve joitalianë, universiteti organizon kurse verore përgatitore, për mësimin e gjuhës italiane në tre nivele. Informacioni rreth programeve të studimit për studentët e mundshëm ofrohet edhe nëpërmjet seancave informuese në shkollat e mesme në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat e Arsimit (më shumë se 80 seanca të zhvilluara), ditëve të hapura të organizuara nga Zyra e Pranimeve në universitet (katër deri në pesë për çdo vit) dhe mbledhjeve të posaçme që organizohen gjatë javës, informacioneve të shtypura dhe ato të publikuar në faqen e internetit. Në varësi të kërkesave të studentëve, ditët informuese organizohen çdo muaj në universitet [A2 fq. 54-55; A13; A97; A46; A47; A48; A106; A107; B27; B30; B31; B32; C13; M7]. [Kapitulli I Standardi III.1]

5.2 Universiteti ka një softuer me anë të të cilit menaxhon me efikasitet informacionin e brendshëm për studentët dhe stafin, ku përfshihet edhe procesi i pranimit. Përveç kësaj, në këtë softuer janë tërësisht të integruara sistemet e emailit të studentëve dhe stafit. Universiteti pohoi që përdoruesit, në përputhje me Politikën e Internetit të Universitetit, mund ta aksesojnë informacionin përkatës në mënyrë të sigurt, duke përdorur fjalëkalimet personale. [A2 fq. 55; <http://unizkm.al/>; M2; M3; M4; M6; M7; C16; Turi] [Kapitulli I Standardi III.2]

5.3 Universiteti, falë Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe bashkëpunimit të saj me Koordinatorët e Programeve të Studimit, ofron një strukturë për dhënien e informacionit dhe këshillimit të studentëve. Rregulloret kanë dispozita të qarta për transferimin e studentëve dhe ky informacion jepet edhe me anë të manualit të studentëve. Fakulteti ruan në sekretarinë mësimore dosjet personale të studentëve me të dhënat e kontaktit dhe notat e shkollës së mesme. Sekretaria ofron udhëzime në lidhje me orientimin e studentëve. Komunikimet e jashtme kryhen me anë të faqes së internetit dhe medias audiovizive, ndërsa komunikimet e brendshme realizohen nëpërmjet rrjetit të brendshëm kompjuterik, i cili përkrah komunikimet e stafit dhe studentëve, ku i gjithë stafi është i pajisur me adresë elektronike. Të gjitha informacionet ruhen në format elektronik dhe të shtypur pranë Sekretarisë Mësimore [A2 fq. 55; B16; B17; M2; M3; M6; M7]. [Kapitulli I Standardi III.3]

5.4 Mentorimi i studentëve realizohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila bashkëpunon ngushtësisht me stafin akademik të programeve të studimit dhe koordinatorët. Ata iu ofrojnë këshilla studentëve rreth të gjitha elementeve të programeve të studimit, transferimit të programeve, vazhdimit të studimeve në ciklin e radhës dhe këshillimit për punësim. [A2 fq. 55; M6; M7] [Kapitulli I Standardi III.3]

5.5 Godinat e universitetit ofrojnë lehtësi në akses për studentët me aftësi të kufizuara fizike, edhe pse aktualisht nuk ka asnjë student me aftësi të kufizuar fizike të regjistruar në asnjë prej programeve. Personeli akademik dhe ai mbështetës i universitetit tregoi gatishmëri për t'i ndihmuar studentët me nevoja të tjera specifike. Universiteti mbështet dhe nxit veprimtaritë sportive dhe ka krijuar një skuadër futbollit, duke vënë në dispozicion edhe ambientet përkatëse të nevojshme [A2 p56; B29; B45; M4; Turi]. [Kapitulli I Standardi III.4]

- 5.6 Në korpus gjendet biblioteka, e cila mbulohet nga një buxhet i posaçëm. Ajo ka një hapësirë me më shumë se 220 karrige. Në të ofrohen më shumë se 15.000 tituj librash, dhe përpjekjet për ta pasuruar dhe për të rritur akoma më shumë stokun e saj, mbështeten nga partnerët dhe programe dhe projekte të ndryshme, ku merr pjesë universiteti. Fondi përbëhet nga një gamë e gjerë librash dhe mjetesh të tjera, si CD, DVD dhe revista të shtypura dhe online. Studentët me kartat e tyre të regjistrimit kanë mundësi ta shfrytëzojnë godinën, e cila frekuentohet mesatarisht nga 500 veta në ditë. Biblioteka ka tekste për të gjitha fakultetet dhe në gjuhë të ndryshme si italisht, shqip, gjermanisht dhe frëngjisht. Ajo ka edhe një sallë studimi dhe konsultimi, hapësira ku mund të aksesohen revistat dhe arkivat online, si dhe një sportel pritës. **[A2 fq.56-58; A92;<http://unizkm.al/>;M3; M4; M7; Tur][Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.7 Studentëve u ofrohet mbështetje mjaft e mirë. Rregulloret parashikojnë tutorimin dhe këshillimin akademik. Studentët pajisen me një manual studenti. Studentët kanë një orar të caktuar të javës gjatë së cilit takohen me tutorët e tyre, dhe sipas studentëve kjo praktikë është shumë e dobishme. Informacione rreth programit ofrohen me anë të aksesit në shënimet e leksioneve dhe materialet e kursit. Studentëve të vitit të parë u ofrohet më shumë mbështetje, si në rastin e studentëve italishtfolës, të cilët kanë në dispozicion 100 orë mësimi të gjuhës shqipe, dhe për studentët shqipfolës, të cilët mund të ndjekin 100 orë mësimi të gjuhës italiane. **[A2 p58; M3; M4; M7][Kapitulli I Standardi III.6]**
- 5.8 Universiteti përkrah Këshillin Studentor dhe financon veprimtarinë e tij. Disa studentë marrin pjesë në Senatin Akademik. Statuti dhe Rregulloret e universitetit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve, shoqëruar nga marrëveshjet dhe financimet për Këshillat Studentorë në nivel fakulteti dhe universiteti. Anëtarët e Këshillit Studentor zgjidhen nga studentët, të cilët përfaqësohen edhe në Këshillat e Fakulteteve. Universiteti ofron burime financiare për të mbështetur punën e Këshillit, dhe studentët pohojnë se ata mund t'i aksesojnë këto burime. Gjithashtu, ata mund t'i propozojnë fakultetit dhe Senatit ndryshime në një program ose mund të kërkojnë mbështetje më të madhe në mësimdhënie dhe gjatë sezonit të provimeve. Studentët pohuan procesin e vlerësimit të pedagogëve të tyre, i cili është i detyrueshëm për çdo lëndë përpara provimit **[A2 fq. 59; A13; A97; A93; A94; B9; B26; M3; M4; M7]. [Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.9 Universiteti iu ofron studentëve mundësi pjesëmarrje në disa aktivitete sportive dhe sociale. Universiteti mbështet dhe nxit veprimtaritë sportive dhe ka krijuar një skuadër futbollit. Stafit dhe studentët pohojnë se këto veprimtari të përbashkëta, duke përfshirë pjesëmarrjen në panairët e punës, aktivitetet sociale dhe konkurset sportive, kanë ndihmuar përfshirjen e tyre në komunitetin e universitetit. Organizohen dy ose tre aktivitete në vit që promovojnë dialogun social, për shembull Përrurimi i Vitit të ri Akademik, Aktivitetet e Fondacionit dhe mbështetja për nismat sociale që kanë të bëjnë me vullnetarizmin. Përveç këtyre, universiteti ndjek politikën e mbështetjes financiare ndaj studentëve, p.sh. si studentët ashtu edhe stafit mund të përfitojnë ulje tarifash të qendrat shëndetësore të Fondacionit, kryesisht në Klinikën Dentare dhe Qendrën e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive. **[A2 fq. 59; A51; B45; C21; M4; M7]. [Kapitulli I Standard III.8]**
- 5.10 Universiteti përkrah nevojat e punëdhënësve dhe të ekonomisë, duke ofruar programe studimi në përputhje me nevojat e tregut të punës. Shoqata Alumni, bashkë me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Kjo Shoqatë shërben si urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe tregut të punës, duke vendosur marrëdhënie me punëmarrës të mundshëm me qëllim promovimin e mundësive të ardhshme të punësimit për studentët dhe hapësirat për kryerjen e stazhit. Pajisja me një diplomë të përbashkët me universitete italiane i jap të diplomuarve epërsi në rast se aplikojnë në sipërmarrje italo-shqiptare që operojnë në Shqipëri, numri i të cilave në Shqipëri arrin më shumë se 500. Norma e punësimit të të diplomuarve është e lartë për të gjitha programet e studimit. Universiteti synon rritjen e punësimit të stafit shqiptar brenda

universitetit dhe institucioneve të Fondacionit. Aktualisht, 24 persona të stafit brenda universitetit dhe institucioneve të Fondacionit janë shqiptarë të diplomuar pranë vetë këtij universiteti [A2 fq. 59-60; B3; B.0; M4; M5; M6; M7][Kapitulli I Standard III.9]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- universiteti është një institucion që veprimtarinë e kryen në gjuhën italiane dhe është i hapur për studentët e huaj veçanërisht për ata që vijnë nga Italia (pika 5.1; Kapitulli I Standardi II.1).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

A. Faza e Vetëvlerësimit

- A1. Të dhëna me Informacione të Përgjithshme
- A2. Raporti i vetëvlerësimit.EN.pdf
- A3 Nr. 1 Grupi i Vetëvlerësimit nr. 114 prot., datë 09.02.2017.pdf
- A4 Nr. 2 Vendim nr. 567, datë 27.08.2004 për dhënien e lejes për hapjen e universitetit.pdf
- A5 Nr. 3 Vendim nr. 466, datë 28.09.1993 për projektin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Kishës Katolike.pdf
- A6 Nr. 3 Vendim nr. 670, datë 28.09.2011. pdf
- A7 Nr. 4 Nr. 661 Prot., datë 31.01.2007 Miratimi i kërkesës për ndryshim strukture.pdf
- A8 Nr. 5 Vendim nr. 6959 /3, datë 15.02.2013 për përgjigjen për ndryshimin e titullit të programit të studimit Ekonomi Biznesi.pdf
- A9 Nr. 6 Memorandum Mirëkuptimi me Qendrën për Formimin e Deputetëve të Evropës Juglindore.pdf
- A10 Nr. 7 Vendim nr. 368, datë 30.01.2013 OSAAB.pdf
- A11 Nr. 8 Vendim nr. 41, datë 17-12-2014 CESPIC.pdf
- A12 Nr. 9 Zhvillimi i programeve të studimit ndër vite e deri më sot.pdf
- A13 Nr. 12 STATUTI I UNIVERSITETIT 2015.pdf
- A14 Nr. 14 Vendim nr. 274 Prot., 14 datë 24.05.2016 për emërimin e Komisionit të Etikës .pdf
- A15 Nr. 14-1 Kodi i Etikës.pdf
- A16 Nr. 15 Nr. 56909 Prot. Anëtarët e emëruar të Komisionit të Përbashkët Teknik Bari.pdf
- A17 Nr. 16 Nr. 168/5 Prot., datë 24.05.2012 Anëtarët e Këshillit të Profesorëve.pdf
- A18 Nr. 17 Nr. 28/15 Prot. datë 15.01.2015, Vendim nr. 03 Përbërja e senatit akademik.pdf
- A19 Nr. Plani i Zhvillimit Institucional.pdf
- A20 Nr. 19 Raporti Vjetor 2015-2016. AL.pdf
- A21 Nr. 21 Prot. 332, Vendim nr. 11 për ndryshimet që lidhen me strukturën e Fakultetit të Mjekësisë datë 22.04.2015.pdf
- A22 Nr. 21 Prot. 333, Vendim nr. 12 për ndryshimet që lidhen me strukturën e Fakultetit të Farmacisë datë 22.04.2015.pdf
- A23 Nr. 21 Prot. 334, Vendim nr. 13 për ndryshimet në strukturën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike datë 22.04.2015.pdf
- A24 Nr. 23 Prot. 257, Përcjellja e vendimeve (Zyrat e administratës dhe departamenteve).pdf
- A25 Nr. 25 Statuti i Universitetit 2005 EN.pdf
- A26 Nr. 26 Rinovimi i Marrëveshjes me Universitetin e Tor Vergata-s.pdf
- A27 Nr. 26 Marrëveshje për trajnimet praktike dhe teorike pranë Spitalit Rajonal të Durrësit.pdf
- A28 Nr. 26 Marrëveshje për promovimin praktik dhe teorik të trajnimeve me Shefqet Ndroqin.pdf
- A29 Nr. 26 Marrëveshje e UniMi bashkë me shtojcat.pdf
- A30 Nr. 26 Marrëveshjet ndërmjet UniFi dhe CUOLGC.pdf
- A31 Nr. 26 Marrëveshje Bashkëpunimi me universitetet partnere italiane dhe universitetet publike shqiptare.pdf
- A32 Nr. 26 Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet UniZKM-së dhe Hygeia-s.pdf
- A33 Nr. 26 Marrëveshje Bashkëpunimi UniTirana & CUZKM, nr. 242 Prot., datë 22.01.2015.pdf
- A34 Nr. 27 Politikat dhe procedurat e menaxhimit të BNj.pdf

A35 Nr. 28 Nr. 165 datë 28 prill 2014, Komisioni i përhershëm për punësimin e stafit administrativ dhe mësimdhënës.pdf

A36 Nr. 29 Nr. 184/14 prot., datë 16.5.2014, Emërimi i Presidentit të Komisionit të Përhershëm për përzgjedhjen e stafit.pdf

A37 Nr. 30 Nr. 131 prot., datë 26.1.2015 Informacion lidhur me vendimin e Senatit.pdf

A38 Nr. 30 Nr. 713/1 prot., datë 06.11.2015 Ndryshimet e strukturës së fakulteteve dhe vendimeve.pdf

A39 Nr. 31 Nr. 339/14 prot., datë 19.09.2014 Format për përzgjedhjen e lektorëve.pdf

A40 Nr. 32 Nr. 339/14 prot., datë 19.09.2014 Rregullore për punësimin e pedagogëve me kohë të pjesshme pranë UNIZKM-së.pdf

A41 Nr. 33 Kontratë Bashkëpunimi.pdf

A42 Nr. 34 i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 001405 datë 13.03.2017.pdf

A43 Nr. 34 Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit në Itali për Komision e Përzgjedhjes për të diplomuarit në Bachelor.pdf

A44 Nr. 37 Përshkrim i të gjithë laboratorëve.pdf

A45 Nr. 38 Raport mjedisor për rindërtimin e Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë.pdf

A46 Nr. 41 Fletëpalosjet informuese.pdf

A47 Nr. 42 Njoftim për procedurat e pranimit për regjistrim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë për kandidatët nga vendet anëtare të BE-së, viti akademik 2015-2016.pdf

A48 Nr. 42 Njoftim për procedurat e pranimit për regjistrim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë për kandidatët nga vendet joanëtare të BE-së, viti akademik 2015-2016.pdf

A49 Nr. 44 Vendim me nr. 0000381 prot., datë 13.06.2014 i Ministrisë së Arsimit në Itali.pdf

A50 Nr. 45 Diplomat e përbashkëta.pdf

A51 Nr. 46 Rregullore për tarifat e studimit për vitin akademik 2016-2017.pdf

A52 Nr. 47 Nr. 406 Prot. Ngritja e komisionit për përzgjedhjen e pranimit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë, viti akademik 2016-2017, datë 24 gusht 2016 .pdf

A53 Nr. 48 Raport për veprimtarinë kërkimore _rezultatet.pdf

A54 Nr. 48-1 Rregullore për veprimtarinë kërkimore.pdf

A55 Nr. 49 Master i Shkencave në Ekonomi dhe Menaxhim.pdf

A56 Nr. 49 Rregullore akademike për programin e studimit Farmaci në Bari.pdf

A57 Nr. 49 Program doktorature në Shëndet Publik.pdf

A58 Nr. 49 Plani i Studimit Doktoraturë në Farmaci.pdf

A59 Nr. 49 Programit i studimit Doktoraturë në Farmaci.pdf

A60 Nr. 49 Rregullore e Masterit të Shkencave në Arkitekturë.pdf

A61 Nr. 49 Rregullore e Masterit të Shkencave në Ekonomi dhe Menaxhim.pdf

A62 Nr. 49 Rregullore e Masterit të Shkencave në Farmaci Milano.pdf

A63 Nr. 49 Rregullore e Doktoraturës në Farmaci.pdf

A64 Nr. 49 Rregullore e Doktoraturës në Statistikë.pdf

A65 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Nivelit të II në Ortondonci.pdf

A66 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Shkencave në Arkitekturë 1.pdf

A67 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Shkencave në Arkitekturë 2.pdf

A68 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Shkencave në Mjekësi, viti akademik 2016-2017.pdf

A69 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Shkencave në Farmaci Bari.pdf

A70 Nr. 49 Plani i Studimit Master i Shkencave në Farmaci Milano.pdf

A71 Nr. 49 Plani i Studimit Doktoraturë në Statistikë.pdf

A72 Nr. 49 Syllabus i Masterit të Shkencave në Arkitekturë.pdf

A73 Nr. 49 Syllabus i Masterit të Shkencave në Mjekësi.pdf

A74 Nr. 49 Syllabus i Masterit të Shkencave në Farmaci, Milano.pdf

A75 Nr. 50 Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë.pdf
A76 Nr. 50 Rregullore e Fakultetit të Farmacisë.pdf
A77 Nr. 50 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike, Ekonomike dhe Sociale.pdf
A78 Nr. 51 Regjistrat e provimeve.pdf
A79 Nr. 51 Suplementi.pdf
A80 Nr. 52 Perceptimi i studentëve për veprimtarinë arsimore, viti akademik 2015-2016 datë 01.11.2016.pdf
A81 Nr. 53 Analizë e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar pranë UniZKM-së.pdf
A82 Nr. 54 Nr. 163/1 Prot., datë 16.09.2015 Emërimi i njësisë së sigurisë së brendshme të cilësisë .pdf
A83 Nr. 55 Rregullore për funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf
A84 Nr. 56 Udhëzuesi Botërore i Shkollës së Mjekësisë FAIMER.pdf
A85 Nr. 57 Treguesit e rezultateve, viti akademik 2015-2016.pdf
A86 Nr. 58 CV Arkitekturë.pdf
A87 Nr. 58 Ekonomi Ita_En.pdf
A88 Nr. 58 MED.pdf
A89 Nr. 58 CV Farmaci Bari.pdf
A90 Nr. 58 CV Farmaci.pdf
A91 Nr. 58 CV Odonto En.pdf
A92 Nr. 59 Rregullore e Bibliotekës.pdf
A93 Nr. 60 Nr. 162 prot., datë 27.01.2015 Rregullore për zgjedhjen e këshillit të studentëve.pdf
A94 Nr. 61 Nr. 059/1-15 Prot., datë 20.07.2015, Alokimi i fondeve për Këshillin Studentor nga KA-ja e Fondacionit.pdf
A95 Nr. 10, Vendimi nr. 375, datë 18.10.2007 për Akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit.pdf
A96 Nr. 11 Akreditimi i dytë institucional nr. 136, datë 25.03.2016.pdf
A97 Nr. 13 Rregullore e UniZKM-së.pdf
A98 Nr. 20 Nr. 131/2015 prot., Vendimet e Senatit Akademik dhe dorëzimi i statutit.pdf
A99 Nr. 22 Organigrama. En.pdf
A100 Nr. 26-1 Marrëveshje Ekzekutive IPH Hulo Hajderi 2015, Doktoraturë në Farmaci.pdf
A101 Nr. 26 Nr. 10 prot., 14 Marrëveshje me Universitetin e Barit 22.01.2014.pdf
A102 Nr. 35 Deklaratat financiare.pdf
A103 Nr. 35-1 Vërtetim Fondacioni ZKM 08.01.2015.pdf
A104 Nr. 39 Grafiku i takimeve me maturanët në shkollat e mesme në Shqipëri.pdf
A105 Nr. 40 Njoftime rreth pranimeve dhe kriterëve.pdf
A106 Nr. 42-1 Informacion rreth kriterëve të pranimit të përcjella MASH-it.pdf
A107 Nr. 43 Vendimet për akreditimin e programeve të përbashkëta të studimit të UniZKM-së.pdf
A108 Nr. 43-1 Vendimet për akreditimin e programeve të përbashkëta të studimit të UniZKM-së.pdf
A109 Nr. 44-1 Vendim për akreditimin e Universitetit të Barit.pdf

B. Faza e shqyrtimit të dokumenteve gjatë vlerësimit

B1 Rregullore akademike e programit Bachelor në Ekonomi Biznesi.pdf
B2 Këshilli administrativ.pdf
B3 Shoqata Alumni.pdf
B4 Emërimi i Komisionit Konsultativ.pdf
B5 Emërimi i Këshillit të Profesorëve.pdf
B6 Këshilli i Rektoratit.pdf

B7 Vendim nr. 466, datë 28.09.1993 i projekt marrëveshjes ndërmjet Qeverisë dhe Kishës Katolike.pdf
B8 Kontratë Sipërmarrjeje.pdf
B9 Dëshmi rreth mbështetjes për alokimin e fondeve për Këshillin Studentor nga K.A-ja e Fondacionit.pdf
B10 Të dhëna rreth punësueshmërisë së të diplomuarve.pdf
B11 Informacion rreth kritereve të pranimit të përcjella MASH-it.pdf
B12 Plani i Zhvillimit Institucional 2017-2027.pdf
B13 Mbledhje për diskutimin e çështjeve që lidhen me veprimtaritë didaktike vlerësuese dhe përmirësuese.pdf
B14 Mbledhje e Komisionit të Përbashkët Teknik.pdf
B15 Mbledhje e Rektoratit.pdf
B16 Mbledhje me studentët e Fizioterapisë.pdf
B17 Mbledhje me studentët e programit të studimit Mjekësi dhe Kirurgji.pdf
B18 Emërimi i Këshillit të Etikës.pdf
B19 Emërimi i Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë.pdf
B20 Njoftim për procedurat e pranimit për regjistrim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë për kandidatët nga vendet anëtare të BE-së, viti akademik 2015-2016.pdf
B21 Njoftim për procedurat e pranimit për regjistrim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë për kandidatët nga vendet joanëtare të BE-së, viti akademik 2015-2016.pdf
B22 Politika për Punësimin e Personelit.pdf
B23 Detyrim Sigurimi për Profesorët.pdf
B24 Menaxhimi i pronave dhe procedurat.pdf
B25 Nr. 163/1 Prot., datë 16.08.2015 Emërimi i Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë .pdf
B26 Rezultatet e Zgjedhjeve të Studentëve.pdf
B27 Grafiku i takimeve me gjimnazistët në shkollat e mesme të Shqipërisë.pdf
B28 Disa propozime për shërbimet e auditimit.pdf
B29 Aktivitetet sociale dhe sportive.pdf
B30 Manuali i studentëve 1.pdf
B31 Manuali i studentëve 2.pdf
B32 Manuali i studentëve 3.pdf
B33 Detyrim Sigurimi për Studentët.pdf
B34 Përmbledhje e mbledhjeve me studentët e Stomatologjisë.pdf
B35 Syllabus Bachelor në Ekonomi dhe Menaxhim.pdf
B36 Tabela e angazhimit të stafit akademik 2016-2017.pdf
B37 Komisioni Mësimdhënës i Fakultetit të Mjekësisë.pdf
B38 Kodi i etikës.pdf
B39 Perceptimi i veprimtarisë arsimore të studentëve, viti akademik 2015-2016 datë 01.11.2016.pdf
B40 Tabela e angazhimit të stafit akademik.docx
B41 Komisioni Mësimdhënës i Fakultetit të Mjekësisë.pdf
B42 Kodi i etikës.pdf
B43 Perceptimi i veprimtarisë arsimore të studentëve, viti akademik 2015-2016 datë 01.11.2016.pdf
B44 Shembull i procedurave udhëzuese për njohjen e krediteve formative të Fakultetit të Mjekësisë, viti akademik 2016-2017.pdf
B45 Detyrim Sigurimi për Lojtarët e Ekipit të Futbollit të Universitetit.pdf
B46 Lista e dokumenteve.pdf
B47 Tabela e ngarkesës mësimore akademike .pdf

C. Faza e vizitës së vlerësimit të jashtëm

- C1 Konferenca + Seminare në Stomatologji.pdf
- C2 Kurse të formimit të vazhdueshëm të organizuara në Qendrën e Rehabilitimit.pdf
- C3 Kurse të formimit të vazhdueshëm të organizuara në kuadër të projektit dhe OSSAB-it.pdf
- C4 Kurse të organizuara pranë qendrës së avancuar të simulimit.pdf
- C5 Dr. G.Lombardi, Bordi Këshillimor Ekonomi 2016.pdf
- C6 Dr. Giordano Gori, Bordi Këshillimor Ekonomi.pdf
- C7 Dr. R.Laera, pjesë e Bordit Këshillimor 2016.pdf
- C8 Dr. L.Peci, Bordi Këshillimor Ekonomi.pdf
- C9 Dr. S.Pedrazzi, Bordi Këshillimor Fakulteti i Ekonomisë 2017.pdf
- C10 Plani i Zhvillimit Institucional për vitet 2004-2006 dhe 2006-2010.pdf
- C11 Seminaret dhe Konferencat, Fakulteti i Ekonomisë.pdf
- C12 Zhvillimi i programeve të studimit ndër vite e deri më sot.pdf
- C13 Zyra e Pranimeve.pdf
- C14 Raporti Vjetor 2015-2016. AL.pdf
- C15 Vendim nr. 368 i OSSAB.pdf
- C16 Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).pdf
- C17 Plani i Zhvillimit Institucional 2010-2017.pdf
- C18 Marrëveshja universitare Cambridge-UniZKM.pdf
- C19 Plani strategjik 2013-14_ 2016-17.pdf
- C20 Pyetësorët + Analiza për vlerësimin e stafit.pdf
- C21 Aktivitetet sociale dhe sportive.pdf
- C22 Statistika për Programet në Gjuhën Italiane 01.01.2015-31.12.2015.pdf

Mbledhjet

- M1 Rektori
- M2 Grupi i Vetëvlerësimit
- M3 Stafi i nivelit të lartë
- M4 Studentët
- M5 Punëdhënësit, Alumni dhe Partnerët
- M6 Stafi Akademik
- M7 Personel Mbështetës
- Turi Turi në korpus